

S T A T U T I

i

"SHOQERISE TREGTARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ULEZA NDERTIMI" Sh.P.K.BURREL.



Ne baze te ligjit Nr.7512, date 10 gusht 1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire, veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit, ne Burrel sot me daten 3 maj 1995, une shteta-si Ndue Shpani me banim ne lagjen "Pjeter Budi" te qytetit Burrel, me vullnetin tim te lire dhe te plote, ne perputhje me legjislacionin ton shqiptar vendosa te krijoje shoqerine tregtare private me pergjegjesi te kufizuar "ULEZA NDERTIMI" Sh.P.K.Burrel.

K R E U I I

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ULEZA NDERTIMI" Sh.P.K! Burrel, eshte person juridik i pavarur, ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijeve te percaktuar ne ligjin Nr.7512 date 10 gusht 1991, kodit tregtar dhe akteve te tjera ligjore.

Neni 2

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj private ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Neni 3

Themeluesi i shoqerise ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij me qellim qe te perfitoi te erdhurat qe mund te vijne nga vep-priatarija private si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin fillestar.

Neni 4

Shoqeria tregtare private "ULEZA"NDERTIMI"Sh.P.K.Burrel, eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj ne gjykaten e rrethit Tirane si dhe paisjen me lejen e ushtrimit te profesionit nga organi kopetente.

EMERI, QENDRA, TERITORI.

Neni 5

Emertimi i shoqerise tregtare do te jete : SHOQERIA TREGTARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ULEZA NDERTIMI"Sh!P.K.BURREL.

Neni 6

Selia e shoqerise tregtare private "Uleza Ndertimi"Sh.P.K. Burrel do te jete ne lagjen "Pjeter Budi" te ketij qyteti. Shoqeri

mund te zhvilloje aktivitetin e saj dhe te çele filiale ne te gjithë teritorine e "epublikes se Shqipërisë.

O B J E K T I

Neni 7

Objekti i veprimtarise tregtare dhe aktiviteti i kesaj shoqërie do te jete :

- Punime ndertimi, montimi, punime restaurimi, ujesjeliesë, kanalizime,
- Prembajtje e sherbime ne sektorin komunal,
- Punime ndertimi sipas liçences te lashuar nga Ministria e Ndertimit
- Tregëti me pakice e shumice, import - eksport ne mallera ushqimor, industrial, fruta perime te te gjitha llojeve,
- Makineri e paisje per shitje e nevoja prodhimi,
- Bufë, restorant, hoteleri,
- Prodhim mallerash ushqimore te gjitha llojeve,
- Prodhim material ndertimi te gjitha llojeve,
- Grumbullim, perpunim i prodhimeve bujqesore e blegtorale,
- Grumbullim dhe tregëtim te bimeve medicinale,
- Tregëtim karburanti, goma e vajra, e
- Sherbime te tjera te ndryshme,
- Si dhe çdo aktivitet tjeter qe veçmas ose se bashku me ato te per mendura me siper do te konsiderohen te pershtateshme per rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë.

AFATI I VEPRIMTARISE

Neni 8

Aktiviteti tregtar i shoqërisë do te zhvillohet me nje afat te paktuar mbi 10 vjet.

Neni 9

Shoqëria eshte e detyruar te mos e ndryshoje destinacionin e saj. Ndryshimi i destinacionit te veprimtarise ekonomike e financiare, brenda dy vjetesh mund te behet me lejen e organeve kopetente perkatese.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 10

Kapitali themelor i shoqërisë tregtare private, "Uleza Ndertimi" Sh.P.K. Burrel perbehet nga nje kapital prej 100.000 lekesh.

Neni 11

Trasferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.

Shoqëria apo te tretet duhet te respektojne keto trasferime sapo ti behen te ditura asaj.



Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashgimie. Ato mund tu kalojne bashkeshorteve, paraardheseve dhe pasardhesve.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

Neni 13

Shoqeria tregtare private "Uleza Ndertimi" Sh.P.K.Burrel do te ket administrator z.Ndue Shpanin. Themeluesi i shoqerise ka te drejte dhe ne kopetence te caktoj si administrator edhe persona te tjere te cilet nuk kane cilesine e Ortakut.

Neni 14

Ortaku i vetem themelues ka ne kopetence :

- Te miratoje programin e shoqerise, te hartoje raportin e administrimit te inventarit, llogarite vjetore te cilat hartohen brenda nje afati 6 - mujor, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.
- Vendos per shperberjen e shoqerise.
- Vendos per ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve.
- Rregullon marredheniet e punesimit e te shperblimit brenda shoqerise.
- Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shtetore, personave juridik vendas e te huaj.
- E te tjera.

K R E U I I I

MARREDHENIET EKONOMIKO FINANCIARE

Neni 15

Shoqeria tregtare "Uleza Ndertimi" Sh.P.K.Burrel, mund te lidhe kontrata me sektore shtetore drejte per drejte me tregun e lire si dhe me persona juridik e fizike, vendas dhe te huaj, sipas legjislativnit ne fuqi per eksport import.

Neni 16

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga z.Ndue Shpani ose persona te tjere te autorizuar prej tij.

Neni 17

Te drejtat dhe detyrat qe rrjedhin nga kontratat jane te detyruar shme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

Neni 18

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve tjera ligjore, shoqeria pergjigjet per kontabilitetin fiskal, afatshme e derdhjes se detyrimeve ndaj shtetit, sigurimet shoqerore etj.



Sipas ligjeve te tatimit mbi fitimin percakton tatimet per veprimtarine tregtare te shoqerise.

Shoqeria ka te drejte te çele llogari prane bankave te vendit dhe huaja ne shqiperi dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet



Neni 19

sigurimin e veprimtarise ekonomike shoqeria ka te drejte te vetfinancohet me leke ose ne valute te huaj.

Neni 20

Shkembimin e monedhes shqiptare ne monedhe te huaj e anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lire privat te valutes.

Neni 21

Te ardhurat nga veprimtaria private, do te sigurohen sipas çmimeve qe i cakton vet shoqeria. Çmimet dhe tarifate do te caktohen sipas kerkeses dhe ofertes.

Neni 22

Per pasqyrimin e aktivitetit tregtar administratori ose persona te tjere te autorizuar nga ortakut i vetem themelues, jane te detyruar te moajne dokumentacion te rregullte financiar dhe rregjistra perkate sipas ligjeve te veçanta.

K R E U I III

MARREDHENIET E PUNESIMIT

Neni 23

Themeluesi i shoqerise per realizimin e veprimtarise merre ne pune punonjes me kontrate pune vjetore ose sezonale.

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates se lidhur lirisht midis paleve.

Neni 24

Punonjesit gezojne lejen vjetore dhe lejen plotesuese sipas kriterave te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre sipas Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise.

Neni 25

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortakut themelues z.Ndue Shpani! Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljeve disiplinore, ose me vet kerkesen e te interesuarit.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 26

Te ardhurat neto, pas shlyerjes se detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqerore etj, kalojne ne pronesi te ortakut te vetem themelues, ose ortakëve ne rast se ka te tille dhe ndahen sipas kontributit te secilit.

Neni 27

Shperblimi per personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise "Uleza Ndertimi" Sh.P.K. Burrel, caktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga themeluesi i shoqerise.

Neni 28



Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i viteti financiar qilind i jane zbritur ose shtuar numerat respektiv te humbjeve apo fitimeve te mbartura nga vitet e mepareshme.

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 29

Themeluesi ne rastin e shtimit te numerit te ortakëve ka te drejt te beje ndryshimet e nevojshme ne statute si dhe te hartoje edhe kontraten e perbashket me ortakët e tjere, duke bere ndryshimet e nevojshme ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se rrethit Tiranes.

Neni 30

Mosmarveshjet e shoqerise ne marredhenie me persona juridike e fizike, vendas e te huaj, zgjidhen me mirekuptim, ne te kunderten, kur kjo nuk arrihet, zgjidhen nga Gjykata e rrethit Tiranes.

Neni 31

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet ligjit Nr. 7512 date 10 gusht 1991 si dhe çdo akti tjeter ligjor te legjislacionit shqiptar.

Neni 32

Statuti perpilohet ne disa kopje per t'ju derguar organeve kompetente. Nje kopje e tij mbetet si pjese e dokumentacionit te formimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Uleza Ndertimi" Sh.P.K. Burrel.

U nenshkrua ne Burrel sot me dt. 3 maj 1995.

Ky statut u pregadite nga

Une, Avokati
(Hajredin Hysa)

AVOKAT
Hajredin Hysa
MAT

ORTAKU I VETEM THEMELUES

/ NDUE SHPANI /